



**BASHKIA PUKË**  
**Sektori Tatim Taksave**

Nr. \_\_\_\_ prot

Pukë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2018

**P/VENDIM**

Nr. \_\_\_\_/\_\_\_\_/, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2018

**PROJEKT PAKETA FISKALE 2019**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_/\_\_\_\_/2018, në zbatim të pikës 3, të nenit 34, pikës 1,2,4,5, të nenit 35, germës “f, të nenit 54, pikës 3, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 142/2015, datë 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar”; Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH.”, i ndryshuar, Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në R.SH.”, Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar; ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, mbështetur në ligjin nr. 24/2017, datë 09.03.2017, ligjit nr. 68/2017 neni 14, pika 5.ç, VKM nr. 783, datë 10.11.2011 “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Udhëzimit të MF nr.1, datë 12.01.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregëtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”; Udhëzimin nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar, VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar; në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Krugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake...” i ndryshuar me ligjin nr. 8335/23.04.1998 të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë pas shqyrtimit të propozimit të projekt-vendimit, me \_\_\_\_ vota pro:

**V E N D O S I:**

**Kap. I.1. TAKSA MBI NDËRTESESAT.**

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me VKM nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtëshme ‘Ndërtesa’, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, kjo në zbatim të Ligjit nr. 106/2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ‘Për sistemin e taksave vendore’, të ndryshuar”.

Në zbatim të ligjit nr. 106, datë 30.11.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ku sipas nenit 6 të tij është shtuar neni 22/1 ‘Baza e Taksës dhe shprehet : - “ Baza e taksës nbi ndërtesat është vlera e

ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse” dhe konkretisht sipas VKM nr. 132, datë 7.3.2018, neni 2 të tij. Vlera e pasurisë së paluajtëshme ndërtesë/njësi pronësore e njohur me dokumenta ligjore, ose vlera e përcaktuar me një nga metodat e përcaktuara në metodologjinë e miratuar, vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen ndërtesë/njësi pronësore;

**Përcaktimi vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtëshme “ndërtesa”, (në zbatim të nenit 2 të VKM nr. 132/2018) është:**

- 1. Përcaktimi i çmimit vlerësues dhe i sipërfaqes së ndërtesës/njësi pronësore, të bëhet sipas nenit 2, pika 1 të VKM nr. 132/2018;**
- 2. Vlera e pasurisë së paluajtëshme “ndërtesë”, referuar verifikimeve në terren, të bëhet sipas nenit 2, pika 2 të VKM nr. 132/2018;**
- 3. Nëndarja zonale/nënzonale brenda territorit të vetëqeverisjes vendore, të bëhet sipas nenit 2, pika 3 e VKM nr. 132/2018, si më poshtë:**
  - a. Niveli shkallës së taksës për banesat për qëllime banimi në hapsirën territoriale Bashkia Pukë të jetë minus 30 % referuar aneksit 1, e çmimit referues të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllime banimi Bashkia Pukë që është 22.000 lek/m<sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzimi;
  - b. Në zbatim të aneksit 2, shkronja “dh” të VKM nr. 132, datë 7.3.2018, për Njësitë Administrative Gjegjan, Rrape, Qelëz, Qerret ( bashkuar njërive të vetëqeverisjes vendore Bashkia Pukë, sipas ligjit 115/2014 ), çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi, të destinuar për banim reduktohet 35 % krahasuar me qytetin Pukë;
  - c. Për ndërtesat e privatizuara sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar, çmimi për m<sup>2</sup> është 70 % e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.
- 4. Vlera e pasurisë së paluajtëshme për ndërtesat e papërfunduara në shkelje të afatit të lejes së ndërtimit, të bëhet sipas nenit 2, pika 4 e VKM nr. 132/2018.**

#### **A. Shkalla e taksës:**

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, në zbatim të ligjit nr. 106, datë 30.12.2017, neni 6, për një shtesë në nenin 22 e konkretisht neni 22/2 të VKM nr. 132/2018, neni 2, pika 5, për efekt të përlllogaritjes së taksës për ndërtesë/njësi pronësore, baza e taksës është si më poshtë:

- a) **0,05 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;**
- b) **0,2 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;**
- c) **30 % e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.**

**B. Përrjashtohen nga taksa mbi ndërtesat ( referuar ligjit nr. 106, datë 30.12.2017, neni 5 të tij, neni 22 në ligjin 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshime, ndryshon në pikën 6 të tij si më poshtë) :**

- a) Pronat e shtetit dhe të njërive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me VKM, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qeramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) Banesat sociale në pronësi të bashkive;

- d) Pasuritë e paluajtëshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) Ndërteat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) Strukturat akomoduese “Hotel/resort me katër e pesë yje, status special”, sipas përc. në legjisll. e fushës së turizmit...;
- ë) Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose në qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- f) Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) Ndërtesat kulturore, nën mbrotje të përkohëshme ose të përherëshme, për kohën në të cilën deklarohet mbrotjtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore”.
- C. Nën kategori specifike ndërtesash dhe qëllimi përdorimit, të bëhet sipas nenit 3, pika 1, 2, 3, 4 e VKM nr. 132, datë 7.3.2018**
- D. Afati pagesës dhe mbajtja e pagesave** të jetë për bizneset deri 20 mars të vitit ushtrimor 100 % e taksës së pronës me zbritje 10 %, likujdimi deri 20 Shtator 100 % e detyrimit dhe pas kësaj date me kamatë vonesë 10 % e detyrimit vjetor.  
Likujdimi do bëhet pranë Degës së Raiffeisen Bank. Për familjarët likujdimi është gjithëvjetor me likujdim të menjëhershëm, ose ndarë në muaj me faturën e ujit pijshëm, kur agjent tatimor është NUK<sup>ja</sup>.  
Për biznesin e madh likujdimi është gjithë vjetor deri 30 Dhjetor të vitit ushtrimor. Pas kësaj date me kamatë vonesë 10,000 lek, për personat biznes i vogël (p.f.) likujdimi deri 20 Mars të vitit me zbritje 10 %, kurse pas datës 20 shtator me kamatëvonesë 10 % të detyrimit tatimor.
- E. Në të gjitha njësitë administrative të tjera, niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale të ndërtesës, është sa ½ e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës**
- F. Agjenti tatimor** Për këtë të zbatohet Akt-Marrëveshja e lidhur mes Bashkia Pukë dhe NUK Bashkisë Pukë: - “ *Marrëveshje për arkëtimin e taksave vendore për abonentët familjar së bashku me faturën e ujit pijshëm*” me nr. 1994 & 457 prot., datë 25.10.2017, nënshkruar mes palëve, mbështetur në pikën 3 të nenit 12 të ligjit 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku citohet : - “...njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të hyjnë në marrëveshje me njëra tjetrën apo me agjent tatimorë për mbledhjen e të ardhurave vendore me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas një procedure transparente dhe konkurruese”. Zyra të ardhurave vendore të dërgojnë taksapaguesve njoftimet dhe faturën tatimore në fillim të periudhës ushtrimore, vjetore ose të ndarë në muaj.

## **Kap. I.2 TAKSA E TABELËS**

Në zbatim ligjit 106/2017, neni 8, pika 1, sipas tabelës Aneksi 7 të saj, Kap. I.8 “Taksa e tabelës dhe/ose reklamës” , **Taksa e Tabelës** do jetë sipas tabelës më poshtë:

### **TAKSA E TABELËS SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE**

#### **Aneksi 7**

<b>Nr.</b>	<b>LLOJET E TABELAVE</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Bashki Kat. III<sup>te</sup></b>
<b>I.</b>	<b>Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuarta ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti biznesit )</b>		
<b>a.</b>	<b>deri në 2 m<sup>2</sup></b>	lekë/m <sup>2</sup> /vit	0
<b>b.</b>	<b>mbi 2 m<sup>2</sup> deri 10 m<sup>2</sup></b>		

	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	7,000
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	11,500
	elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	15,000
<b>c.</b>	<b>mbi 10 m<sup>2</sup> deri 20 m<sup>2</sup></b>		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	5,950
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	9,775
	elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	12,750
<b>ç.</b>	<b>mbi 20 m<sup>2</sup> deri 40 m<sup>2</sup></b>		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	3,850
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	6,325
	elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	8,250
<b>d.</b>	<b>mbi i 40 m<sup>2</sup></b>		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m <sup>2</sup> /vit	2,800
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m <sup>2</sup> /vit	4,600
	elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	6,000
<b>II.</b>	<b>Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim</b>		
	Tabela identifikuese	lekë/m <sup>2</sup> /vit	120
<b>III.</b>	<b>Tabelë për qëllime identifikimi e lëvizëshme e palëvizëshme deri në tavanin maksimal 35 m<sup>2</sup></b>		
	e thjeshtë me/pa ndriçim	lekë/m <sup>2</sup> /vit	13,500
	elektronike	lekë/m <sup>2</sup> /vit	27,000
<b>IV.</b>	<b>Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.</b>		
	të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m <sup>2</sup> /vit	1,000

### **Mënyra përlllogaritjes.**

(Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m<sup>2</sup>, shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m<sup>2</sup> do ti shtohet shuma e taksës së llogaritur për diferencën e sipërfaqes mbi 10 m<sup>2</sup> të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.Sh., një tabelë të thjeshtë 15 m<sup>2</sup>, shuma e taksës vjetore do të llogaritet:  $(10m^2 * 15,000 \text{ lekë}) + (5m^2 * 12,750 \text{ lek}) = 150,000 + 63,750 = 213,750 \text{ lekë/vit}$ , ose  $17,812 \text{ lek/muaj}$ ). E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m<sup>2</sup> dhe mbi 40 m<sup>2</sup>.

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë. Çdo tabelë që kalon sipërfaqen 35 m<sup>2</sup>, do të konsiderohet sikur është 35 m<sup>2</sup> dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m<sup>2</sup>.

Në kategorinë e reklamës kuptojmë çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në pamje joballore, në tarraca, lozhë, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj. që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretët.)

### **Kapitulli I/3 TAKSA E TRUALLIT**

Në ligjin nr. 142/2015 datë 17.12.2015, neni 12 i tij, pas nenit 23 të ligjit nr. 9632, shtohet neni 23/1 “Taksa mbi truallin”, përcakton se niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale, të bazës së taksës sipas aneksit 2.1 të këtij ligji, është:

1. Për qëllime banimi nga individët është 0.14 lek/m<sup>2</sup>/ vit
2. Për qëllime biznesi është 12 lek/m<sup>2</sup>/vit

- **Baza e taksës** është sipërfaqja e truallit në m<sup>2</sup> në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim pranë Bashkisë ku ndodhet trualli. Kjo sipas aneksit 2/1 të ligjit nr. 142/2015 datë 17.12.2015.
- Niveli taksës caktohet në lek/m<sup>2</sup>. Detyrimi taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.
- Të zbatohet neni 12 ligjit 142/2015 që përcakton komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtëshme sipas nenit 24 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

### **Kapitulli I.3 TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE**

Taksa mbi tokën bujqësore vlerësohet si taksë vendore bazuar në Ligjin 9632 datë 30.10.2006 , i ndryshuar, neni 9 “Llojet e taksave vendore”. Bazuar në nenin 23 të këtij ligji, taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor i taksapaguesit që kanë në përdorim ose në pronësi tokë bujqësore përfituar sipas ligjit 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën”. Në Bashkinë Pukë, kategoria e tokës për të cilën aplikohet taksa mbi tokën bujqësore është kategoria VII-X.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Detyrimi për pagesën e taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme (Neni 23 ligji 9632 datë 30.10.2006). Kategoritë minimale të tokës bujqësore janë përcaktuar në Aneksin 2 të ligjit 9632 datë 30.10.2006, shprehur në neni 21 të tij, ndryshuar me ligjin 10117 datë 23.04.2009.

Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore janë të ardhura që derdhen 100% për llogari të buxhetit të Bashkisë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetë-deklarim të sipërfaqes të tokës bujqësore pranë Bashkisë ku ndodhet toka. (sipas përcaktimeve të nenit 11 i ligjit 142/2015 dhe nenit 24 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar).

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Kategoritë e tokës bujqësore	Njësia	Niveli taksës mbi tokën bujqësore		
		Niveli sipas ligjit	Niveli taksës 2019 Nj.Ad. Pukë	Nj.Ad. Tjera 2019
Kategoria VII-X	(lek/ha/vit)	700	700	500

#### **Dokumentacioni për efekt të taksës**

- 1) Për efekt të detyrimit për pagimin e taksës, Sektori i të Ardhurave në Bashkinë Pukë njuh si dokument vërtetimin e pronësisë sipas regjistrimit të Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme e cila njofton rregullisht çdo 3 muaj pa shpërbllim Bashkinë, për ndryshimet dhe rregjistrimet e reja (neni 24 i ligjit 9632, datë 30.10.2006) dhe vetëdeklarimin e përcaktuar në nenin 11 të ligjit 142/2015.
- 2) Sipërfaqe e tokës bujqësore përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë ( ligji 7501 datë 19.07.1991, formulari 6, akti i pronësisë ).

### **Mënyra e pagesës**

- 1) Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e taksës mbi tokën bujqësore është Zyra e të Ardhurave Vendore e cila, brenda muajit Janar të vitit ushtrimor i dërgon të gjithë taksapaguesve, objekt i taksës, akt detyrimit për pagesën e taksës si pjesë e akt detyrimit për të gjithë taksat dhe tarifatat vendore për të cilat ky grup taksapagues është objekt taksimi.
- 2) Pagesa e taksës bëhet përgjatë vitit ushtrimor por jo më vonë se muaji Nëntor pranë arkës së Bashkisë, kur taksapaguesi është abonent familjar për pagesën e faturës së ujit pijshëm, ose në të gjithë Agjencitë Bankare të nivelit të dytë prezente në Bashki konform mandat pagesës së dërguar nga Zyra e Taksave Vendore.
- 3) Në rastet e mospagesës, Zyra e Taksave Vendore evidenton taksapaguesin si debitor dhe ndjek të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve fiskale konform ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R Sh” me ndryshime.
- 4) Ngarkohet Sektori Bujqësisë në Bashki për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin e verifikimin e periudhës së mbjelljes së kulturave dru-frutore dhe vreshtari, për çdo fermerë/fermë.
- 5) Ngarkohet Sektori Bujqësisë pranë Bashkisë Pukë për përcaktimin e sipërfaqeve në pronësi sipas personave, duke pasqyruar edhe ndryshimet e herëpashërshme duke ia përcjellë këtë informacion Sektorit të Ardhurave në Bashki.

### **Përfundimet nga pagesa e taksës**

Perjashtohen nga taksa e tokës bujqësore tokat që mbillen me kultura dru frutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

### **Kapitulli I.4. Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël.**

Në zbatim të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar,

- a. Niveli i Tatimit për subjektet e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, me qarkullim vjetor nga 0-5 milion lek/vit është 0 lek/vit.
- b. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim nga 5-8 milion lek/vit, është 5 %.

Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan në llogarinë e organeve tatimore ose në Postës Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor.

### **Mënyra, afati i pagesës dhe lehtësirat tatimore**

- a) Të ardhurat nga taksa vendore mbi tatimin për fitimin e thjeshtuar për biznesin e vogël transferohen 99% në buxhetin e Bashkisë ku ka vendndodhjen biznesi dhe mbi të cilat Bashkia ka autoritet të plotë menaxhimi dhe administrimi dhe 1% e arketimve kalon për llogari të administrates tatimore qendrore (neni 18 i ligjit 181/2013).
- b) Pagesa e detyrimit për taksën vendore mbi tatimin mbi fitimin e thjeshtuar për biznesin e vogël bëhet në të gjithë degët e agjencive bankare në territorin e Bashkisë Pukë mbi bazën e akt detyrimit të subjekteve fizik dhe derdhet në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, e cila më pas nëpërmjet akt-rakordimit me Zyrën Tatimore të Bashkisë Pukë, bën kalimin e arktimeve në llogarinë e saj të Degës së Thesarit në Pukë.

- c) Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi tatimin mbi fitimin e thjeshtuar mbi fitimin, është Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër.
- d) Kundravajtjet dhe sanksionet do të zbatohen duke u mbështetur në ligjin 9632 datë 30.10.2006, neni 34 dhe ligjit nr. 9920 dt.19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar.

### **Kategorizimi i bizneseve**

Për efekt të klasifikimit dhe kategorizimit të bizneseve si dhe vlerësimit të detyrimit tatimor për taksën vendore mbi biznesin e vogël, klasifikimet janë në përputhje me Udhëzimin nr. 655/1 datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve proceduriale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”.

### **Kapitulli I.5.Taksa e fjetjes në hotele**

Taksa e fjetjes në hotel është klasifikuar si taksë vendore bazuar në ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Bashkia për natë të qëndrimit, me numrin e netëve të qëndrimit në Hotel. (neni 26 i ligjit 9632, datë 30.10.2006, ndryshuar me ligjin nr. 142/2015 neni 13 i tij).

<b>Emërtimi</b>	<b>Niveli taksës 2019 (ai dhe niveli ligjor)</b>
Hotele, 4-5 Yje	105/lekë për natë qëndrimi hotel
Bujtinë, fjetinë, motel dhe ç’do njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin .	35/lekë për natë/qëndrimi në hotel

### **Pagesa e taksës**

- 1) Derdhja e të ardhurave për këtë taksë bëhet nga hoteli në favor të Bashkisë në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij , bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.
- 2) Për vjeljen dhe administrimin e taksës së fjetjes në hotel ngarkohet Zyra e Taksave Vendore të Bashkisë Pukë.

### **Kapitulli I.6. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja**

Sipas ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore” të ndryshuar”, me ndryshime, ligjit 142, datë 17.12.2015, ‘Për disa ndryshime në ligjin 9632/2006 të ndryshuar”, neni 14 i tij, baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit “.

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në Udhëzimin e KM ” Per miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave” që miratohet çdo vit.

Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa për ç’do rast mblidhet nga organi që e lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet për llogari të Bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

### **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja**

Nr.	Llojet e ndërtimeve/investimeve	Njësia matjes	Niveli taksës së ndikimit në infrastrukture për v. 2019		
			Niveli	Nj. Ad.	Njësitë Ad.

			ligjor	Pukë	T` tjera
1	Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë, apo përdorim publik është 4-8 % ( sipas ligjit )	Në % vlerës së investimit	4	4	4
2	Ndërtime të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër është 1 – 3 % sipas ligjit	Në % vlerës së investimit	1 - 3	2,5	2
3	Për projektet e infrastrukturës për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave etj., taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0.1 % e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit, përfshirë makineritë dhe paisjet.	Në % vlerës së investimit	0,1	0,1	0,1
4	Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 % e vlerës.	Në % vlerës së investimit	0,5	0,5	0,5

### **Kapitulli I.7 Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtëshme**

Në zbatim të të përcaktimeve sipas ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore” me ndryshime, neni 28 “Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtëshme”, pika 1, 2, 3, 4 të tij, **taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtëshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtëshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Kjo për ndërtesë, tokë bujqësore, truall.**

Sipas aneksit 3 të ligjit 142/2015, dt.17.12.2015, niveli taksës për kalimin e pronësisë mbi ndërtesën ( zona 3 ) është:

<b>Kategoritë e ndërtesave</b>	<b>Bashkia Pukë</b>
I. Ndërtesa banimi	100 lekë /m <sup>2</sup>
II. Ndërtesa të tjera për tregëti e shërbime	300 lekë /m <sup>2</sup>
III. Ndërtesa të tjera	200 lekë /m <sup>2</sup>

**Përfshihen** nga pagimi taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtëshme sipas përcaktimeve në nenin 29 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore” me ndryshime. Sipas Udhëzimit nr. 29/30.07.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë”, pika 4 e tij të parashikuar në nenin 28, të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1999, “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshime”, ndryshuar me ligjin 38/2018 neni 1 të tij, në nenin 8/1, pika 11, vjelja e kësaj takse bëhet nga zyra regjistrimit të pasurive të paluajtëshme, të cilat në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 % të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Përfshitimi nga pagimi kësaj takse në zbatim të nenit 29 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar.



## **Kapitulli I.8. Taksa Kombëtare që ndahen me njësitë e qeverisjes vendore**

### **I.8/a Taksa vjetore e mjeteve të përdorura**

Në zbatim të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 25, “Të ardhurat nga taksat e ndara”, pika 2 shkronja b, sipas VKM Nr.783, dt.10.11.2011 “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar me VKM nr. 923, datë 29.12.2014.

#### **Specifika mbi taksën**

Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura njësia vendore, në rolin e përfituesit, **përfiton 25 %** të të ardhurave vjetore nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura.

### **I.8/b Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale**

**Mbështetur në ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara”, pika 2 shkronja “ç”, 2 % e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale kalojnë njësitë të qeverisjes vendore .**

## **Kapitulli II TARIFAT VENDORE 2019**

Si pjesë e të ardhurave vendore, në mbështetje të ligjit 9632 datë 30.10.2006, neni 35 i ligjit.

### **II.1. Tarifa për zënjen e hapsirës publike**

Në zbatim ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 15 “Tarifa për zënjen e hapsirës publike dhe të fasadave”, pika 1/a.b,c,f,g dhe sipas nenit 16, të ligjit nr. 142/2015, datë 17.12.2015, për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ‘Për sistemin e taksave vendore’, nenit 35, “Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”, pika 1, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje : - paguhet për zënjen e hapsirave publike për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin e mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar. Tarifa për zënjen e hapsirës publike, nuk zbatohet për hapsirat që nuk janë në pronësi e nën administrimin e pushtetit vendor. Tarifat për vitin 2019, do jenë si më poshtë:

Nr.	Zënia e hapësirave publike	Tarifa në 2019
A	Shfrytëzim hapësirë publike tortuare, sheshe para dyqaneve	60 lek/m <sup>2</sup> /muaj
B	Shfrytëzim hapësirë publike jashtë ndërtesë për Bare, Kafe, Restorante etj.	66 lek/tavolinë/muaj

Për hapsirat publike nga Zyra e Urbanistikës në Bashki të bëhet vijëzimi e miratimi hapsirave si sheshe, trotuare, sheshe para objekteve tregtare ku lejohet vendosja tavolinave dhe objekteve për tregëtim.

Për vjeljen e të ardhurave nga kjo tarifë ngarkohet zyra vendore e të Ardhurave në Bashki.

### **II.2 Tarifa e lejeve të zhvillimit të territorit**

Në ligjin 107/2014 ‘Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit ‘, dhe akteve nën/ligjore në fuqi si VKM nr. 1096, datë 28.12.2015 “ Për miratimin e rregullores, kushteve e procedurave për përdorimin e menaxhimin e hapsirave publike ‘, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, VKM nr. 671, datë 29.07.2015 “ Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit ‘, **në zbatim të Vendimit të KKT nr. 1 datë 20.06.2018 “Për**

**miratimin e Planit Përgjithshëm Vendor, Bashkia Pukë”, VKM nr. 355, datë 19.04.2017 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 408, datë 13.05.2015 për “Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, për vitin 2019, tarifat do të jenë:**

### **II.2/a Tarifa të urbanistikës e planifikimit territorit**

<b>Nr.</b>	<b>Llojet e tarifave</b>	<b>lek/dosje</b>	<b>Tarifa 2019</b>
<b>1</b>	<b>Tarifë aplikimi për leje zhvillimi</b>	lek/dosje	5000
<b>2</b>	<b>Tarifë aplikimi për leje ndërtimi:</b>	lek/dosje	10000
<b>3</b>	<b>Tarifa të aplikimit të deklaratës paraprake të punimeve</b>	lek	2000

Struktura e ngarkuar për vjeljen e këtyre tarifave është sektori të ardhurave pranë Bashkisë Pukë , ndërsa ajo për lëshimin e autorizimeve të pagesave për tarifat e urbanistikës do jetë Drejtoria Urbanistikës dhe e planifikimit të territorit pranë Bashkisë Pukë.

### **II.3. Tarifa e Pastrimit dhe largimit të mbeturinave**

#### **Kategoritë taksapaguese**

Kategoritë dhe nënkategoritë taksapaguese, objekt i tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave janë si më poshtë:

- 1) Familjet me dy nënkategori:
  - a. **Familjet në ndihmë ekonomike dhe**
  - b. **Familjet e tjera**
- 2) Subjektet private me dy nënkategori
  - a. **Subjektet fizike**
  - b. **Subjektet juridik**
- 3) **Institucionet**

#### **Niveli i tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave**

Nga përlogaritja e kostos së shërbimit të pastrimit dhe blerjes së kazanëve të transportit të mbeturinave që ofrohet nga Bashkia Pukë, kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së Pastrimit dhe Largimit të Mbeturinave për Bashkinë Pukë, ku ofrohet ky shërbim, kjo dhe për Njësitë Administrative, janë të shprehura si më poshtë:

#### **Tarifa e Pastrimit**

<b>Nr.</b>	<b>TARIFA E PASTRIMIT</b>	<b>Viti 2019</b>
<b>I.</b>	<b>Familjet (për çdo k/familjar)</b>	
	1. Qytet Pukë	1500
	- Familjet me ndihmë ekonomike	700
	2. Në Njësitë Administrative	500
	- Familjet me ndihmë ekonomike	300
<b>II.</b>	<b>Biznesi Vogël</b>	
<b>1</b>	<b>Shitje me shumicë e pakicë</b>	
	a. Bylmet, mish, peshk	10000
	b. Fruta perime e ushqimore	15000
	c. Artikuj industrial (veshmbathje, parfumeri, argjendari etj.)	8000
	e. Bar-kafe, Fast-food, Kafe-internet, floktore, berber	10000
	f. Restorante, mëngjezore, etj. këtij lloji	15000
	g. Lojra kompjuterike për fëmijë	10000

	<b>Për Njësitë administrative 50 % e Bashkisë Pukë</b>	
	- Biznes i Madh ( Shitje )	30000
<b>2</b>	<b>Prodhime</b>	
	a. Punime e përpunim duralumini, metalesh, druri etj.	15000
	b. Prodhime ushqimore, ëmbëltore, byrektore, ëmbëlsira, prodhim buke etj.	10000
	<b>Për Njësitë administrative 50 % e Bashkisë Pukë</b>	
	- Biznes i Madh :	
<b>3</b>	<b>Shërbime</b>	
	a. Riparim artikuj elektro shtëpiak, televizor, frigorifer, lavatriçe etj.	10000
	b. Shërbime fotografike, fotokopje, sallon bukurie, rrobaqepësi, bilardo, ambjente sportive, këpuctar, marangoz, lavazh etj.	10000
	c. Shërbime si TV Kabllor, të tjera të këtij lloji	15000
	d. Tregti karburanti e gazi me pakicë, servise makinash	15000
	<b>Për Njësitë administrative 50 % e Bashkisë Pukë</b>	
<b>4</b>	<b>Profesione të lira Biznes i Vogël</b>	
	a. Avokat, noter, inxhiner, projektues.	10000
	b. Farmaci bujqësore, veterinare	8000
	c. Klinika dentare, farmaci humanitare, laboratore mjeksore etj.	20000
	<b>Për Njësitë administrative 50 % e Bashkisë Pukë</b>	
<b>III.</b>	<b>Biznes i Madh</b>	
	- Njësi shërbimi biznes i madh	30000
	- Punime duralumini, metalesh, druri, biznes i madh	40000
	- Prodhime ushqimore, buke, ëmbëlsira, mishi, peshku, bylmeti	40000
	- Prodhime konfeksionesh biznes i madh	50000
	- Subjekte ndërtuse për selinë administrative	50000
	- Subjekte me leje minerale përpunim gurore me kontratë me qeverisjen vendore	150000
	<b>Subjektet e ndërtimit sipas investimit dhe kohëzgjatjes së kantjerit të ndërtimit tarifa e pastrimit lek/kantjer/vit është:</b>	
	- Për vlera investimi deri 5,000,000 lek	20,000 lek/kantjer/vit
	- Për vlera investimi deri 5,000,001-15,000,000 lek	40,000 “
	- Për vlera investimi deri 15,000,001-25,000,000 “	60,000 “
	- Për vlera investimi deri 25,000,001- 50,000,000 lek	80,000 “
	- Për vlera investimi deri 50,000,001-100,000,000 “	100,000 “
	- Për vlera investimi deri 100,000,001 -200,000,000 “	150,000 “
	- Për vlera investimi mbi 200,000,000 lek	200,000 “
	- Shërbime artizanale biznes i madh	30000
	- Profesione të lira biznes i madh	30000
	- Hotele, motele, shtëpi pushimi, turizëm familjar etj. biznes i madh	200 lek/dhomë/vit
<b>IV.</b>	<b>Institucionet për Bashkinë Pukë</b>	
	1. Zyra V R P.P	50000
	2. Zyra Postare	40000
	3. Dega e Thesarit	40000
	4. Agjensia Lokale e Sig. Shoq. Nr. 29	30000
	5. Gjykata Rrethit Pukë, Prokuroria Rrethit Gjyqësor Pukë	50000

6. Zyra Vendore Punesimit	20000
7. AlbTelekom	100000
8. F.F.A Dega Pukë	50000
9. N/Prefektura	20000
10. OSHEE Pukë- Zyrat	100000
11. Komisarjati Policisë	50000
12. Drejtoria e Shërbimit Spitalor	80000
13. Dega e Rezervës Shtetërore	10000
14. Drejtoria Arsimore	50000
15. Raiffeissen Bank Dega Pukë	60000
16. N/Stacioni Elektrik;	100000
17. Kompani sigurimesh, Agjenci Këmbimi Valutor,	40000
18. Drejtoria e Shëndetit Publik	60000
19. Filiale të kompanive të sigurimeve dhe kompanive celulare	20000

### **Përjashtimet nga tarifa e pastrimit**

- a) Do të përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit kategoritë si më poshtë:
- i. invalidët e punës
  - ii. të verbërit
  - iii. të sëmurët tetraplegjikë dhe paraplegjikë
- b) Përjashtimet do të bëhen në rastet kur veprimet bëhen në emër të përfituesit, pra kur përfituesi është kryefamiljar. Kategoritë përfituese do të duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së të Ardhurave Vendore Çertifikatë familjare (ku tregohet lidhja me kryefamiljarin), Librezën e Veteranit, Invalidit të Luftës, Invalidit të Punës, statusin e të verbërit, të sëmurëve paraplegjik dhe tetraplegjik, librezën e pensionit dhe vërtetimin nga Dega e Shoqatës respektive.
- c) Degët e Shoqatave të Invalidëve të Punës, Luftës, të sëmurëve para dhe tetraplegjik, të verbërve, **brenda muajit Janar** të vitit ushtrimor duhet të depozitojnë zyrtarisht kopje të listës së personave përfitues së bashku me shënimet për statusin familjar të personit (numrin e personave në ngarkim dhe statusin familjar).

### **II.3 Tarifa e Ndrëçimit Rrugor dhe agjenti tatimor.**

Aplikimi Tarifës së Ndrëçimit Rrugor mbështetet në Kreu VII, neni 35 të ligjit 9632 dhe ligjit 10117 datë 23.04.2009, neni 5. Në asnjë nga njësitë administrative të Bashkisë Pukë, përjashtuar qyteti Pukë dhe qendra në Nj.Ad. Gjegjan, nuk ofrohet shërbim ndrëçimi rrugor, prandaj edhe për këto njësi janë të përjashtuara nga kjo tarifë. Të ardhurat nga tarifa e ndrëçimit rrugor janë të ardhura vendore dhe derdhen 100% për buxhetin vendor. Destinacioni përdorimit të të ardhurave nga tarifa e ndrëçimit rrugor është financimi i shpenzimeve të shërbimit të ndrëçimit rrugor. Zyra e Taksave Vendore në Bashki, së bashku me të dhënat për taksën e ndërtesës për kategorinë e ndërtesave të banimit, tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për abonentët familjarë vë në dispozicion të Ndërmarrjes së Ujësllësisë listën e familjeve objekt i tarifës së ndrëçimit rrugor për kategorinë familje. Të dhënat për familjet në ndihmë ekonomike merren brenda muajit Janar të vitit ushtrimor nga Zyra e Ndhmës Ekonomike në Bashki. Për subjektet private, ndërmarret dhe institucionet, Zyra e Taksave Vendore në Bashki është përgjegjëse për arkëtimin dhe administrimin e të ardhurave nga tarifa e ndrëçimit rrugor.

Niveli tarifës së ndrëçimit rrugor për Bashkia Pukë Qytet, (jo për Njësitë Administrative, për të cilat nuk aplikohet Taksë Ndrëçimi, pasi nuk u kryhet ky shërbim), sipas kategorive taksapaguese është si më poshtë:

- |                                     |             |
|-------------------------------------|-------------|
| 1) Për familjet                     | 200 lek/vit |
| 2) Për familjet me ndihmë ekonomike | 100 “       |
| 3) Për subjektet fizik biznes vogël | 1,500 “     |

- |                                    |                |
|------------------------------------|----------------|
| 4) Për subjektet Biznes Madh       | 2,500 “        |
| 5) Degët e kompanive të sigurimeve | 2,000 “        |
| 6) Për institucionet               | 20,000 lek/vit |

#### Afati dhe vendi pagesës

- Për subjektet private, afati pagesës është jo më vonë se 20 Shtator i vitit ushtrimor. Përtej këtij afati zbatohen sanksionet e parashikuara në paketën fiskale.
- Për institucionet, kompanitë e sigurimeve, degët e agjencive bankare, posta, kompanitë celulare pagesa bëhet gjatë vitit ushtrimor në arkën e Bashkisë ose në Agjencitë Bankare prezente në Bashki.
- Për familjet:**

Për taksapaguesit “**abonentë familjarë**” Bashkia Pukë, tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave është **gjithë vjetore**,

Rolin e **agjentit tatimor e luan Ndërmarrja e Ujësllësit** e cila në rolin e agjentit tatimor shpërndan dhe arkëton përgjatë gjithë vitit buxhetor (Janar-Dhjetor) detyrimin për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave sipas listë pagesave (listës së detyrimit për çdo familje) të vënë në dispozicion nga Zyra e të Ardhurave Vendore e Bashkisë. Ndërmarrja e Ujësllësit, derdh çdo ditë shumat e arkëtuara për efekt të tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe njëherësh dorëzon listën e personave të cilët kanë shlyer detyrimin konform procedurave të miratuara në **Akt - Marrëveshjen** midis palëve të nënshkruar më parë me nr. 1994 prot., datë 25.10.2017 për Bashkinë Pukë dhe nr. 457 prot., datë 25.10.2017 për NUK-në Bashkia Pukë.

Për familjet në skemën e **ndihmës ekonomike**, pagesa e tarifës do të bëhet në arkën e Bashkisë jo më vonë se **muaji Qershor i vitit ushtrimor**. Zyra e Ndihmës Ekonomike në Bashki bashkëpunon me Zyrën e të Ardhurave Vendore për realizimin e këtij detyrimi ligjor.

#### Për ndërmarrjet, entet, institucionet

Për ndërmarrjet, entet dhe institucionet, biznesin e vogël e të madh, rolin e agjentit tatimor do e ketë Zyra e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Pukë.

#### II.4. Tarifa e parkimit të automjeteve.

Në zbatim ligjit nr. 8379, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, neni 7, të ndryshuar me ligjin nr. 175, datë 18.12.2014, Tarifës së Parkimit të Automjeteve i nënshtrohen të gjithë personat fizik, juridik rezidentë në Bashkinë Pukë dhe të cilët posedojnë mjet, pavarësisht llojit të tij dhe që shfrytëzojnë vendparkimet e përcaktuara nga Bashkia.

**Në përputhje edhe me VKB për miratimin e Terminalit të Autobuzave sipas planimetrisë së paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Pukë, nivelet e tarifës së parkimit të mjeteve në vendparkimin e miratuar, për çdo kategori mjeteve janë si më poshtë:**

Nr	Lloji Mjetit	Niveli Tarifës 2019
1	Autobuza të linjave ndërqytetase	15000 lek/vit/mjet
2.	Autobuzë të linjave rrethqytetase	8000 lek/vit/mjet
3.	Kamiona deri në 3.5 ton	10000 lek/vit/mjet
4.	Kamiona mbi 3.5 ton	15000 lek/vit/mjet
5.	Persona fizik që nuk janë rezident në Bashki	50 lek/orë qëndrimi
6.	Autovetura deri në 6+1 vende	50 lek/orë/qëndrimi

- Zyra e Taksave Vendore në Bashki, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, ngarkohet për vjeljen dhe administrimin e tarifës së parkimit.

2. Të ardhurat nga tarifa e parkimit të automjeteve derdhet 100% në buxhetin e Bashkisë Pukë.
3. Zyra e shërbimeve (transportit) në Bashki luan edhe rolin e agentit tatimor për këtë tarifë, për subjektet që pajisen me leje transporti dhe liçencë e kryen këtë shërbim punonjësi i ngarkuar nga Bashkia Pukë.
4. **Struktura përgjegjëse për grumbullimin e të ardhurave është Zyra të Ardhurave në Bashki nëpërmjet një punonjësi të ngarkuar për këtë shërbim.**

## II.5. Tarifa të tjera vendore

Nr	Emërtimi i Tarifës	Njësia	Tarifa 2019
<b>1</b>	<b>Tarifa të përherëshme :</b>		
	Për vulosje veterinerë të bagëtive të therura në vende therje të aprovuara, sipas nennit 54, ligjit 10465, dt. 29.09.2011:		
1.1	- për bagëti të trasha	lek/kokë	150
1.2	- për therje bagëti të imta	lek/kokë	100
<b>2</b>	<b>Të ardhura nga tarifa shërbimi:</b>		
	<b>a.</b> Dhënie në përdorim stadiumi futbollit, për një ndeshje futbollit një skuadre jo vendase	lek	50000
	<b>b.</b> Nga dhënia në përdorim e ambjenteve të qendrës sociale për aktivitete të ndryshme	lek	20000
2.1	Bileta Sporti – tribuna kryesore	lek	200
2.2	Bileta sporti – vendet e tjera	lek	100
2.3	E ardhura nga dhënia në përdorim ditor të përkohshëm për sallën e madhe të Pallatit të Kulturës	lek/aktivitet	15000
2.4	E ardhur nga dhënja në përdorim ditor të përkohshëm për sallën e vogël të Pallatit të Kulturës.	lek/aktivitet	5000
2.5	Të ardhura jo tatimore nga :		
	- fjetje në konvikt e konviktorëve	lek/nxënës/vit	3000
	- tarifë për kopshte	kuota ditore/lek	75
	- tarifë për çerdhet	lek/fëmijë	80
	- të ardhura nga tregtimi ditor me automjete deri 1.5 ton brenda rrethimit Tregu Lirë	lekë/ditë	200
	- të ardhura nga tregtimi ditor me automjete nga 1.5 deri 3 ton brenda rrethimit T. Lirë	lekë/ditë	300
	- Për automjetet mbi 3 ton brenda rrethimit Tregu i Lirë	lekë/ditë	500
	- tarifë ditore e tregtarëve në ambjentet e tregut qytetit, pronë e Bashkisë Pukë	lekë/ditë	100
<b>3.</b>	- Zënje hapsire publike ditore për qëllime biznesi: ekspozim – promocion i produkteve, shërbimeve, aktiviteteve tregëtare, etj.	lek/m <sup>2</sup> /ditë	200

Mbështetur në ligjin nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për taksat vendore”, neni 33 - taksa të përkohëshme vendore, kreu VII, neni 35, pika 2, Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35 - të ardhura që rrjedhin nga burimet e veta vendore, pika 5, shkronja “a” deri “ç” e saj, pjesë

e grupit të tarifave vendore janë edhe tarifa nga aktivitetet ekonomike dhe funksionesh të cilat përmbushen nga Bashkia Pukë si e ardhura jo tatimore për akomodim në konvikt e konviktorëve nga fshatrat e rrethit Pukë.

## **II.6. Të tjera të ardhura**

Mbështetur në ligjin 9632, dt. 30.06.2006 “Për taksat vendore” me ndryshime, neni 35 “Tarifat vendore dhe administrimi tyre”:

- a. Për ambulatët ditor që tregtojnë prodhime familjare, pagesa të jetë 50 lek/ditë në ambjentet jashtë tregut,
- b. Për automjetet ambulante ditore pagesa të jetë 1500 lek/ditë qëndrimi për tregtim në sheshin “Imer Bardhoshi” në vijëzimet e përcaktuara më parë.

### **Për administrimin e tarifave dhe të ardhurave të mësipërme, ngarkohet:**

- Për tarifën e therrjes së bagëtive ngarkohet veterineri Bashkisë
- Për të ardhurat nga veprimtaritë ekonomike, ngarkohet Zyra e Kulturës dhe Sportit dhe drejtoria e Qendrës Sociale dhe Zyra e Financës.
- Për të ardhurat nga bileta sporti, ngarkohet zyra e shërbimeve në Bashki.

## **II.7. Tarifa lejesh, liçencash dhe autorizimesh në fushën e transportit rrugor**

Mbështetur në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportin rrugor”, me ndryshime, ligj nr. 10/2016 dt. 11.2.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, Udhëzimin e MPPTT nr. 15, dt. 24.07.2007 “Për kriteret e procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e transportit rrugor” i ndryshuar, Udhëzimi i MPPTT nr. 20, datë 10.10.2007, “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, Udhëzimit të Ministrisë Transportit dhe Industrisë nr. 5627, datë 18.11.2016, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, përcaktohen tarifat e lejeve, liçencave dhe të autorizimeve në fushën e transportit rrugor, Udhëzimit të MTI nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, Udhëzimit të MTI nr. 5630, datë 21.11.2016, “Për kriteret e licencimit për të kryer kontrollin dhe provën e mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve”, Shkresa nr. 6154/2 prot.datë 29.12.2016 të MTI “Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesat në tarifat e pagesave për liçenca/çertifikata që lëshohen në transportin rrugor të udhëtarëve”, në zbatim edhe të shkresës nr. 17905/1 prot., datë 27.12.2016 e MF të D.P.B. dhe D.M.Buxhetit .

Këto tarifa mbështeten në aktivitetin e zyrës së transportit dhe shërbimeve në Bashki dhe të ardhurat e grumbulluara janë të ardhura që ndahen sipas përcaktimeve në Udhëzimet e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Për liçencat e automjeteve me afat një vjeçar, vlera llogaritet duke e pjestuar me detyrimin sipas afatit në vite.

### **Shënim:**

- a. Për dublikatë me të njëjtin përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30 % e vlerës së plotë të dhënë në tabelë.
- b. Për rastet e ndryshimeve në liçencë/çertifikatë që kanë të bëjnë me përdoruesit e mjetit, fushës së operimit etj., paguhet 30 % e vlefës së plotë.

Në Bashkinë Pukë, niveli i tarifave për leje, liçenca, autorizime dhe çertifikata në fushën e transportit rrugor është sipas tabelave të përcaktuara në këto udhëzime

**Agjenti tatimor** do të jetë Zyra e Shërbimeve në Bashki që lëshon e plotëson këto liçenca e autorizime në bashkëveprim me Zyrën e Tatim Taksave të Bashkisë.

## **II.8 Tarifat e shërbimeve që kryen Struktura e Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimi ndaj shtetasve dhe personave juridik, fizik, vendas e të huaj:**

Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi përcaktohen në zbatim të ligjit nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” si dhe të VKM nr. 285, datë 27.06.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj”.

Sipas VKM nr. 707, datë 12.10.2016, pika 1, Stacioni Shërbimit të MZSH-së Bashkia Pukë, në rast ofrimi shërbimi bashkive të tjera, “Tatrima e shërbimit për shuarjen e zjarreve apo për shpëtimin, në raste aksidentesh dhe fatkeqësish të tjera, ...” është 15,000 lek/orë pune”.

## **II.9 Tarifa shërbimit të ujitjes .**

Nga shërbimi për ujitje të tokave bujqësore që ofrohet nga Ujëmbledhësi Rezervuarit Kukaj fashtrave të Njësisë Administrative Luf-Qerret, mbështetur në ligjin nr. **24/2017, datë 09.03.2017, kreu IV, neni 15, 16, neni 18** , “Tarifa e shërbimit të ujitjes”, pika 1, 2, 3 e tij , ligjit nr. **68/2017 neni 14, pika 5.ç**, kjo tarifë të jetë **100 lek/orë ujitje**. Agjent tatimor për mbledhjen e kësaj tarife për periudhën e vaditjes caktohet një punonjës shërbimi nga Njësia Administrative Luf-Qerret, Bashkia Pukë.

## **II. Të ardhura të tjera:**

### **II.1 E ardhur nga shfrytëzimi në sektorin e pyjeve për prodhim dru zjarri për popullatën**

Mbështetur në VKM nr. 433, datë 08.06.2016, sipas përcaktimit të nenit 3, të ligjit nr.5/2016, datë 04.02.2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në RSH”, Përcaktimi tarifave në sektorin e Pyjeve e të Kullotave, të bëhet sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, në shtojcën “Për tarifat në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, tarifat bazë të lëndës drusore në këmbë, lidhja 1/a, për dru zjarri të llojit dushk, ah, etj., është:

- Tarifa e parashikuar **500 lek/ m<sup>3</sup>**

- Për tarifat e tjera sipas tabelave të shprehura në VKM<sup>-të</sup> e mësipërme për këto tarifa.

### **II.2. E ardhura nga Renta Minerare**

Për mbledhjen e të ardhurave nga renta minerare, sipas **Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017, neni 25 pika 2/c**, ligjit nr. 157/2014 datë 27.11.2014 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, neni 2, pika 2 gërma “b” e cila përcakton se: - “ **5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.**”

Për objektet pronë e qeverisjes vendore, që jepen me qira vjetore, të zbatohet VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”

### **IV.Të ardhura Jo tatimore**

Sipas përcaktimeve ligjore pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, funksional (jo ndërtesë), makineritë e paisjet dhe linjat e prodhimit.

Të ardhurat nga qiratë paguhen nga përfituesi dhe shfrytëzuesi i pronës në pronësi të bashkisë, bazuar në kontratën e lidhur mes palëve.

Drejtoria Juridike, Njësia e Prokurimit, dhe sektori i Aseteve kryejnë procedurën e plotë të dhënjes me qira deri në hartimin e kontratës dhe kërkojnë lëshimin e faturës nga ana e Zyrës së të Ardhurave. Ndjekja dhe zbatimi i kontratës kryhet nga Sektori i Aseteve.

## **IV.1 LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE QË DO TË VENDOSEN NGA POLICIA BASHKIAKE NË RASTET E SHKELJEVE DHE KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE.**



Bazuar në ligjin nr. 139/2015, ‘për vetëqeverisjen vendore’, ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997, ‘Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake dhe të komunës’, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998, ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, ‘Për planifikimin e territorit’, të ndryshuar, ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011, ‘Për shërbimin veteriner në RSH’ të ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 ‘për kundravajtjet administrative’, i ndryshuar, neni 6/b, neni 7/3, 10/3 e në vijim, Bashkia ka të drejtë të vendosë nëpërmjet këshillit bashkiak , llojet e gjobave dhe nivelin e tyre deri në 20,000 lekë. Në rastet kur kundravajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte. Në çdo rast masa e dënimit nuk mund të jetë më e madhe se 20,000 lekë.

Nr.	Lloji i gjobave	Niveli i Gjobës
<b>IV.1</b>	<b>Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa licencë, autorizim apo leje përkatëse si më poshtë:</b>	
<b>IV.1.a</b>	<b>Mospajsa me licensë, autorizim apo leje përkatëse transporti</b>	
<b>1</b>	Motokarro	2,000
<b>2</b>	Transport udhëtarësh me taksi 4+1	10,000
<b>3</b>	Transport udhëtarësh me taksi 8+1	15,000
<b>4</b>	Mjete të tonazhit të lartë	20,000
<b>5</b>	Hyrje pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tanazhit të lartë,	15,000
<b>IV.1.b</b>	<b>Mospajsa me leje tregëtimi me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombulave të gazit</b>	10,000
<b>IV.1.c</b>	Mospajsa me leje tregëtimi ambulant, kantinë	5,000
<b>IV.1.d</b>	Mospajsa me leje për shërbim me tavolinë jashtë lokalit	5,000
<b>IV.1.e</b>	Mospajsa me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh"	10,000
<b>IV.1.ë</b>	<b>Mospajsa me leje për zënje të hapsirës publike</b>	
	1. Ekspozim malli	10,000
	2. Veprimtari që do të zhvillohen në hapsirat publike	5,000
<b>IV.1.f</b>	<b>Mospajsa me leje për vendosje reklame</b>	
	1. Të thjeshta	10,000
	2. Elektronike	20,000
<b>IV.1.f</b>	<b>Mosmarrja e masave për izolimin e ambjentit për daljen e zhurmave nga ambjentet e lokalit</b>	
		20,000
<b>IV.1.h</b>	<b>Mos respektim i rregullave të qarkullimit të jetë si më poshtë:</b>	
<b>1</b>	Parkim të gabuar	1,000
<b>2</b>	Zënie trotuari	20,000
<b>3</b>	Qarkullim i mjetit duke shkelur rregullat e qarkullimit (sinjalistikës)	2,000
<b>4</b>	Marrja e mjetit me karrotrec	5,000
<b>IV.2.a</b>	<b>Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore, të jetë si më poshtë:</b>	
<b>1</b>	Dëmtim rruge	20,000
<b>2</b>	Çarje rruge	20,000
<b>3</b>	Bllokim rruge	10,000

4	Dëmtim bordure	10,000
5	Dëmtim trotuari	10,000
6	Çarje trotuari	20,000
7	Bllokim trotuari (inerte, material etj.) nga biznese	15,000
8	Bllokim rruge e trotuari ( ambulante e familjarë )	2,000
9	Dëmtim, bllokim, vjedhje pusetash	10,000
<b>IV.2.b</b>	<b>Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit për punime në qytet</b>	
1	Persona juridik	20,000
2	Persona fizik	10,000
3	Qytetarë	2,000
4	Hedhje e inerteve në vende të pamiratuara nga bizneset	20,000
5	Hedhje e inerteve në vende të pamiratuara nga familjarët	10,000
6	Hedhje e mbetjeve urbane në rrugë, trotuare dhe hapsira publike jashtë vendeve të përcaktuara ( nga familjarët )	1,000
7	Hedhje e mbetjeve urbane në rrugë, trotuare dhe hapsira publike jashtë vendeve të përcaktuara ( nga bizneset )	10,000
8	Dëmtim kosha mbeturinash	20,000
9	Dëmtim stola pushimi	10,000
<b>IV.3. a</b>	<b>Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor, si më poshtë:</b>	
1	Lidhje e pa miratuar në rrjetin rrugor	20,000
2	Dëmtim të shtyllave të ndriçimit	20,000
3	Dëmtim i ndriçuesve	20,000
4	Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllave etj.	10,000
5	Dëmtim i traseve, kabllave dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulla e shtyllave	20,000
6	Ndërhyrje në kuadrot elektrik publik	10,000
<b>IV.3. b</b>	<b>Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit</b>	
1	Lidhje e pa miratuar në tubacion	20,000
2	Dëmtim të pusetave	20,000
3	Dëmtim i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me ose pa leje	20,000
4	Dëmtim të matësive të ujit pijshëm	20,000
<b>IV.4.</b>	<b>Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapsirat e gjelbërta dhe publike të jetë si më poshtë:</b>	
1	Dëmtim i hapsirave publike të gjelbërta	20,000
2	Dëmtim, prerje e pemëve	20,000
3	Zënie e hapësirave publike të gjelbërta pa leje	20,000
4	Vendosje tabelash, pankartash, banderola pa leje	5,000
5	Vendosje postera pa leje	5,000
6	Mos ndërtim i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane të subjekteve të ndërtimit për objektet mbi 5 kate	20,000
7	Për mishin e therur tregtuar dhe të pa çertifikuar nga inspektorati veteriner	10,000

Në zbatim të ligjit 10279, datë 20.05.2010 ‘Për kundërvajtjet administrative’, të ndryshuar për arkëtimin e vlerës së gjobave vepron konformë nenit 30.1 të këtij ligji.

#### **V. Detyrimi për zbatimin e Paketës Fiskale të vitit 2019**

- a) Struktura e ngarkuar për mbledhjen e këtij detyrimi është Zyra e Taksave dhe Tatimeve Vendore në Bashkinë Pukë dhe të gjitha drejtoritë dhe zyrat të cilat lidhen me zbatimin e elementëve të kësaj paketë fiskale.
- b) Për të gjithë rastet e gjobave për kundërvajtjet e konstatuara ngarkohet për vendosje dhe arkëtim Policia Bashkiake e cila për kundërvajtje dhe gjopa brenda kuadrit ligjor të policisë bashkiake koordinon veprimtarinë e saj me Policinë e Qarkullimit Rrugor dhe të Rendit.
- c) Mbajtja dhe kontabilizimi gjobave dhe sanksioneve bëhet nga Zyra e Financës në Bashki.

I. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Tatim Taksave.

II. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit **55** pika **6**, e ligjit **139/2015** ‘Për Vetëqeverisjen Vendore’.

III. Shpallur me datë \_\_\_\_\_

Hartuesi

Juriste

**K R Y E T A R I**

**P.Z.T.Taksave**

**Halit D I N I**

**Aida SINANI**

**GJON G J O N A J**